



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM
Nr 44 Datë 10.4.09

**MBI MIRATIMIN E FONDIT PËR DHENIE NDIHME FINANCIARE PER
SPORTISTET ORNELA LALAJ DHE GRISEL NDARDHARI**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës «Mbi miratimin e fondit për dhënie ndihme financiare për sportistet Ornela Lalaj dhe Grisel Ndardhari», bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise», në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008, "Për buxhetin e vitit 2009", në Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 « Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» si dhe në VKB nr 12 dt 13.02.2009 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009 », mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 200.000 lekë për sportistet Ornela Lalaj (100.000 leke) dhe Grisel Ndardhari (100.000 leke).

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të bashkisë me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet	00	04980 05	Art 6090000	-200,000 lekë
Shtohet	00	01110 05	Art 6060000	+ 200,000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase
Raimonda Nase